

GYPSUMTOP

BOJË ME BAZË UJI OPAKE (MAT) PA AROMË ME FUQI MBULUESE TË LARTË PËR KARTONXHES – ME THARJE TË SHPEJTË
seri 030

PËRSHKRIMI

Bojë akrilike me bazë uji për mure për sipërfaqe të brendshme, aplikim direkt në kartonxhes. Formulimi unik i jep asaj fuqi të lartë mbulimi që në aplikimin e shtresës së parë, duke fshehur papërsosmëritë e sipërfaqes dhe duke krijuar një sipërfaqje homogjene, opake (Mat) me bardhësi të lartë. Lehtësia e saj e aplikimit e bëjnë atë veçanërisht të përshtatshme për aplikim me rrul.

UDHËZIME PËR PËRDORIM

E aplikueshme në sipërfaqe të brendshme në:

-Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi.

-Suvatime të reja dhe të vjetra.

-Bojra të vjetra transpirante të aplikuar mirë.

Sipërfaqet duhen përgatitur përshtatshmërisht duke ndjekur me kujdes paragrafin "Përgatitja e Sipërfaqes".

Mos aplikoni në sipërfaqe të fresketa (të sapo suvatuara) dhe me tendencë alkaline, prisni kohën e përshtatshme të maturimit, tharjes përgjithësisht 4 javë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

-Forma lidhëse: kopolimer akrilik në tretësirë ujore.

-Klasifikimi i cilësisë së ajrit të brendshëm: A+

-Klasifikimi sipas UNI EN 13300:

Rezistenca ndaj larjes 11998 ISO: klasi 3

Shkëlqimi EN ISO 2813: <5, mat(opaco)

Fuqia mbuluese për ISO 6504-3: klasa 1 me rreze mbulimi 7 m²/l.

Karakteristika të tjera

-Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1.59±0.05 kg/l

-Viskoziteti UNI 8902: 26400±4000 cps në 25 °C

(Viskometër Brookfield)

-Rezistenca ndaj larjes UNI 10560: >1500 cikle, rezistente.

-Rezistenca ndaj Alkaleve UNI 10795: Rezistente

-Koha e tharjes (në 25 °C dhe 65% RH): për t'u prekur pas 45-60 minutash; Rilyerja pas 3 orësh.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi të rregullta dhe kohezive, të njëtrajtshme:

-Në sipërfaqe të thatë, hiqni çdo papastërti duke e zmeriluar.

-Në sipërfaqe shumë absorbuese, përdorni aplikoni me penel një shtresë GYPSUMTOP të holluar në 50% me ujë.

-Vazhdoni me aplikimin e GYPSUMTOP sipas udhëzimeve në instruksionet për aplikim.

INSTRUKSIONE MBI APLIKIMIN

-Kushtet e ambientit dhe të materialit:

Temperatura e ambientit Min. +8°C / Max. +35°C

Lagështira relative e ambientit <75%

Temperatura e sipërfaqes: Min. +5°C / Max. +35°C

Lagështira e sipërfaqes: <10%

Mos aplikoni direkt në rrezet e diellit.

-Mjetet: rrul me fije leshi ose mikrofibër, pinel, furçë ose pistoletë.

-Numri i shtresave: 1- 2.

-Hollimi me ujë.

-Me pinel rreth 25-35%

-Me rrul rreth 20-25%

-Kur lyerja aplikohet me furçë ose pistoletë hollimi varion në bazë të mjetit dhe presionit të përdorur.

-Pastrimi i pajisjeve bëhet me ujë, menjëherë pas përdorimit.

-Shkalla e mbulimit: 14-16 m²/l për shtresë duke iu referuar aplikimit mbi sipërfaqe të lëmuar dhe mesatarisht absorbuese.

Shkalla e përhapjes është mirë të përcaktohet me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

NGJYROSJA

Ngjyrimi realizohet nëpërmjet Sistemit Marcromie dhe me ngjyruerit COLORADO seria 548.

Në rast përdorimi të fabrikimeve të ndryshme është e këshillueshme të bëhet ripërzjerja e produkteve me qëllim evitimin e ndryshimit të ngjyrës.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C

Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C

Qëndrueshmëria në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte temperature të përshtatshme: 2 vjet.

TË DHËNA MBI SIGURINË

Vlera limite EU (Dir. 2004/42/EC)

Cat. A/a: Veshje Mat për ambiente të brendshme për mure dhe tavane. (shkëlqimi <25@60°) (baze uji): 30 g/l (2010)

GYPSUMTOP përmban max: 1 g/l VOC

Përdorni produktin sipas normave të higjenes dhe sigurisë, pas përdorimit mos hidhni ambalazhet në ambient, lërin mbeturinat të thahen dhe trajtohen si mbetje të veçanta.

Për më shumë informacione konsultohuni me skedën e sigurisë.

EMËRTIMI

Bojë e lashme, akrilike, mat, veçanërisht për sipërfaqe kartonxhesi.

Aplikimi mbi sipërfaqe të përgatitura për GYPSUMTOP seri 030, me bazë uji dhe me bazë rezinë akrilike në tretësirë ujore, në sasinë e përcaktuar nga absorbimi i sipërfaqes së sfondit.

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti i produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.